VENDIM
Nr. 367, datë 29.5.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 3, ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË GRANTIT SUEDEZ NR. TF014255, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA SUEDIA, E PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (SIDA), PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr.3, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së grantit nr.TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lënda: Granti nr. TF014255
Granti Suedez për Bashkëfinancimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes për Shqipërinë – Shtyrje e datës së mbylljes

ZYRËS SË BANKËS BOTËRORE
ZNJ. LINDA VAN GELDER
DREJTORE RAJONALE, BALLKANI PERËNDIMOR
RAJONI I EVROPËS DHE AZISË QENDRORE
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e 4 Shkurtit", nr. 34, Tiranë

E nderuar znj. Drejtore,

Në përgjigje të letrës suaj, datë 3 dhjetor 2018, lidhur me konfirmimin e pranimit nga BNRZH-i të kërkesës tonë për ndryshimin dhe caktimin e datës 31 maj 2020 si afatin më të vonshëm për qëllimet e seksionit 3.03, të aneksit të letër marrëveshjes (Marrëveshja) së datës 30 maj 2013 ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Bankës Botërore), në cilësinë e administratores së fondeve të grantit të dhënë nga Suedia, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA)", për projektin e lartpërmendur, të ndryshuar, Këshilli i Ministrave miraton në parim marrëveshjen ndryshuese, sa vijon:

{"Marrëveshja ndryshuese nr. 3 me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së grantit suedez nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes"

Në vijim të darkordësisë së arritur me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, lidhur me ndryshimin e afatit të përfundimit të marrëveshjes së grantit suedez nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes, Këshilli i Ministrave shprehet parimisht dakord që afati i përfundimit të projektit të shtyhet deri më datën 31 maj 2020.

Ky parashikim ndryshon nenin 3, pika 3.03 të aneksit të marrëveshjes bazë të nënshkruar mes palëve.

Ky ndryshim hyn në fuqi, pasi palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme.}

Me respekt,

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

BANKA BOTËRORE
BNRZH – IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE
Praterstrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

3 dhjetor, 2018

Drejtuar: SH.T.Z. Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
SHQIPËRI

Ref.: Granti nr. TF014255
Granti Suedez për Bashkëfinancimin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Vaditjes për Shqipërinë – Shtyrje e datës së mbylljes

I nderuar Z. Ministër,

I referohemi Letër Marrëveshjes (Marrëveshja) së datës 30 maj 2013 ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratores së fondeve të grantit të dhënë nga Suedia, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) për projektin e lartpërmendur, të ndryshuar.

Gjithashtu, në përgjigje të shkresës suaj të datës 29.8.2018, në të cilën kërkohet shtyrja e datës së mbylljes së marrëveshjes së lartpërmendur nga data 31 maj 2019 më 31 maj 2020, ju informojmë me kënaqësi se BERZH-i e pranon kërkesën tuaj dhe cakton datën 31 maj 2020 si afatin më të vonshëm për qëllimet e seksionit 3.03 të Marrëveshjes.

Me respekt

(nënshkrimi)

Linda Van Gelder

Drejtore Rajonale për Ballkanin Perëndimor, Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore

Për dijeni: Z. Erjon Luci, Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë
Znj. Aurora Alimadhi, Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Z. Patrizio Pagano, Drejtor i Përgjithshëm në Bankën Botërore.

Tel: +43 (1) 2170 782 Faks: +43 (1) 2170 701